



Datë: 11.08.2025
Numër Protokolli: 5523/2025

A.nr.1249/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1249/2025, të datës 30.06.2025, të parashtruar nga ankuesi Sh.N, nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publikë, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 11.08.2025, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1249/2025, e datës 30.06.2025, e parashtruar nga ankuesi Sh.N.

A r s y e t i m

Ankuesi Sh.N (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), me datë 30.06.2025, ka parashtruar ankesë për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes të cilës ka kërkuar që të iniciohet procedurë disiplinore ndaj Kryetarit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publikë për shkak të sjellës që bien ndesh me detyrat zyrtare dhe parimet e shërbimit civil.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 10.07.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publikë (tutje KRPP), ndërsa ky i fundit me datë 16.07.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) si prova i administroi: Ankesën me numër protokolli 4429/2025 të datës 30.06.2025 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e ID-së së ankuesit; Emailin e datës 26.06.2025 nga O.V për ankuesin; Emailin e datës 26.06.2025 nga ankuesi për O.V; Emailin e datës 25.06.2025 nga A.R për A.I; Emailin e datës 25.06.2025, 24.06.2025 , 23.06.2025 nga A.H për A.R; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 10.07.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 16.07.2025; Vendimin Nr.06-V-261 të datës 08.11.2018 të Kuvendit të Republikës së Kosovës; Njoftimin e datës 02.10.2023 për Kryetarin e Kuvendit të Republikës së

Kosovës nga Kryetari i KRPP-së; Eamilin e datës 27.06.2025 nga O.V për A.L, O.B dhe P.K; Kërkesën për trajtimin e shkeljeve të supozuara nga Drejtori IT-së të datës 27.06.2025 për Komisionin Disiplinor; Akt Emërimit të datës 12.03.2025.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatohet se ankesa e ankuesit **është e pabazuar, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit, ka gjetur se ankuesi sipas Akt emërimit me Nr. 08/2025 të datës 12.03.2025, është i punësuar në pozitën Drejtor i Departamentit për Sistem të Prokurimit Elektronik në KRPP.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se Kryetari i KRPP-së përmes emailit të datës 26.06.2025 drejtuar ankuesit, ka treguar sjellje që bien ndesh me detyrat zyrtare dhe parimet e shërbimit civil, konkretisht i njëjti refuzon komunikimin zyrtar dhe bashkëpunimin profesional, duke përdorur edhe tone kërcënuese karshi meje. Kërkon të iniciohet proces disiplinore kundër Kryetari të KRPP-së.

Kolegji i Këshillit, gjatë shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, konstaton se sipas nenit 3 paragrafi 1 i Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, përcaktohet: *1. Ky ligj nuk zbatohet për funksionaret/ët publik si në vijim: 1.1. të zgjedhurat/it; 1.2. anëtarët/ët e Qeverisë dhe zëvendëset/it e tyre; 1.3. funksionaret/ët e emëruar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, Presidentja/i i Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, titullaret/ët apo anëtarët/ët e organeve drejtuese kolegjiale të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të agjencive të pavarura, përjashtimisht pozitat e përcaktuara si në paragrafin 2. të nenit 5 të këtij ligji; 1.4. të emëruarat/it politik në nivelin qendror dhe lokal, përjashtimisht pozitat e përcaktuara në paragrafin 6. të nenit 5 të këtij ligji, e për rrjedhojë, Kryetari i KRPP-së përjashtohet nga fushëveprimi i këtij ligji ngase Kryetari i KRPP-së propozohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe emërohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës siç parashihet me nenin 89 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, e mbi këtë bazë i njëjti nuk ka statusin e zyrtarit publik në këtë rast të nëpunësit të shërbimit civil.*

Duke qenë se Ligji Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë, ka për qëllim rregullimin e marrëdhënies së punës së zyrtares/it publik në institucionet e Republikës së Kosovës, atëherë Kolegji i Këshillit, konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk ka mandat ligjor që të inicioj procedurë disiplinore ndaj Kryetarit të KRPP-së, dhe për rrjedhojë pretendimet ankimore të ankuesit për inicim të procedurës disiplinore ndaj Kryetarit të KRPP-së nuk gjejnë mbështetje ligjore, kështu që ankuesi për çdo pretendim të tillë mund t'i drejtohet organit mbikëqyrës të Kryetarit të KRPP-së, dhe organeve të tjerë sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1249/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit Sh.N;
- Organit të punësimit: Kryetarit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publikë dhe Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në KRPP; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.